

Përmbledhje Jo-Teknike

SHOQËRIA: ALBA PALLETE & PELLETS SHPK

ME VENDNDODHJE NË LAGJIA NR 6, RRUGA E PATOKUT, SHESHI I
HAPUR, LEZHE, LAC

AKTIVITET: Veprimtarite e lëndës së drurit (ID 7.10 B) dhe Menaxhimi i
mbetjeve (ID 5.4 c)

Shoqëria: "ALBA PALLETE & PELLETS" Shpk

Hartoi: "GR Albania" Shpk



**PROJEKTI: Veprimtarite e lëndës së drurit (ID 7.10
B) dhe Menaxhimi i mbetjeve (ID 5.4 c)**

Porositës:	ALBA PALLETE PELLETE SHPK
Hartoi:	 www.gralbania.com



Rruga "Sami Frashëri", Nd. 19, H. 8, 1019, Tiranë, Albania

Web: www.gralbania.com

E-mail: info@gralbania.com

Tel: +355 4 5629742

Përmbajtja e raportit

1. HYRJE	3
2. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	4
3. MENAXHIMI I MBETJEVE	8
Ndikime në cilësinë e jetës	12
Ndikime në cilësinë e jetës	14

Përmbajtja e figurave dhe tabelave

Figura 1: kanali mbledhes per ujrak e zeza**Error! Bookmark not defined.**

1. HYRJE

Subjekti “ALBA PALLETE & PELLETE SHPK” ka operuar me një leje mjedisore të Tipit C me numër identifikimi të lejes 37 datë 04.07.2019 për objektin “Prodhim i produkteve te perbera teresisht apo kryesisht nga druri, nese veprimtaria perfshin sharrimin, shpimin, ferkimin me rere, gdhendjen, torinimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik te drurit, me vendndodhje në Lezhe, Lac, Lagjia nr.6, Rruga e Patokut, Shesh i Hapur, ZK. Nr.2365, me Pasuri nr. 36/21.

Në mbështetje të ndryshimit të Legjislacionit mbi lejet e mjedisit Ligji Nr 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, shoqëria synon aplikimin për leje mjedisi të re tipit B referuar aktoivititetit te saj.

Përshkrim i shkurtër i veprimtarisë:

Subjekti “ALBA PALLETE & PELLETE” ushtron veprimtarinë e tijë, pranë rrugës së Patokut, Lagjia nr 6, Bashkia Kurbin. Pronësia e tokës është në emër të shoqërisë “ALBA PALLETE & PELLETE” SHPK me sipërfaqe totale 8400 m², nr. Pasurie 36/21, zk.2365, sipas certifikatës se pronesisë nr. 1889706, leshuar nga ZVRPP-Kurbin.

Ky subjekt ka per qellim prodhimin e paletave dhe pelletave per tregun industrial si dhe menaxhimin e mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje drusore) të cilat riciklohen duke u fut në prodhim. Lenda e pare qe perdoret per kete veprimtari jane ristelat e drurit, materiale ndihmese (gozhde), mbetje drusore, etj. Energjia qe perdoret eshte ajo elektrike nga rrjeti i zones. Kapaciteti i projektuar eshte 500 m³/muaj palete dhe 166 ton pellete /muaj-2000 ton pelete/vit. Zhurmat dhe vibracionet qe gjenerohen jane ato te makinerive gjate procesit të punes. Mbetjet urbane dergohen ne konteniere te caktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore.

Shoqëria synon aplikimin per leje mjedisi te tipit B me:

- **ID: 7.10/b Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri nqs veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.**
- **ID: 5.4 c Rikuperim I mbetjeve jo të rrezikshme**

2. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti “ALBA PALLETE & PELLETS” SHPK, i regjistruar në QKB më datë 19/02/2019, me nr. NIPTI: L97619302U ka objekt aktiviteti: Prodhim, tregtim, import - eksport paleta. Prodhim dhe tregtim të artikujve bujqësore.

Fusha e veprimtarisë e subjektit do të jete:

- *Veprimtaritë e lëndës së drurit. ID: 7.10 b Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri nëq veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.*
- *Menaxhimi I mbetjeve ID: 5.4 c Rikuperim I mbetjeve jo të rrezikshme*

Vendndodhja e instalimit: Lezhë Lac LAC Kurbin, Zona Kadastrale Nr.2365, numri i pasurisë 36/21 me një sipërfaqeje totale prej 8400 m².

MAGAZINIMI DHE SELEKSIONIMI I MBETJEVE JO TE RREZIKSHME

Mbetjet që do të magazinohen në territorin ku është vendosur impianti I perpunimit të paletit dhe peletit do të jenë kryesisht paleta të përdorura. Mbetjet si fillim do të seleksionohen në varesi të formës së tyre. Ato mbetje të cilat kanë formë të rregullt dhe të pademtuar do të përdoren për krijimin e paletave të reja.

Mbetjet të cilat kanë formë të demtuar dhe që nuk mund të përdoren në krijimin e paletave të reja, do të futen në perpunim për prodhim peleti.

Mbasi të jete bërë seleksionimi paraprak, këto mbetje do të dërgohen në afërsi të hapësirës së dedikuar të impianitit të perpunimit sipas procesit që do të nënshtrohen.

Mbetjet që do të rikuperohen, jo të rrezikshme janë:

1. Mbetje ambalazh druri 15 01 03
2. Dru 170201

PRODHIMI PALETIT

Në këtë instalim zhvillohen të gjitha proceset e nevojshme për prodhimin e paletave të drurit.

Makinëritë që përdoren për zhvillimin e proceseve kryesore janë presa, plani, sharra elektrike, kompresori etj.

Në objekt janë kryer të gjitha investimet e nevojshme për zhvillimin e këtij aktiviteti. Niveli

akustik dhe vibrimet nuk vlerësohen të jenë shqetësues pasi nuk do të ketë veprimtari të cilat do të gjenerojnë zhurma apo vibrime mbi norma.

Ristelat e drurit dhe paletat e përdorura janë lëndë e parë që do të përdoren për ndërtimin e paleteve.

Ristelat e drurit do të jenë në forme të gatshme në gjëndje për prodhimin e paleteve. Nuk do të jetë e nevojshme sharrimi, zdrukthimi i tyre. Sasia e ristelave të drurit që do të jetë e nevojshme për prodhimin e paleteve do të jetë në kapacitetin maksimal 300 m³ në muaj.

Paletat e përdorura të cilat janë seleksionuar para se të sillen brenda në magazine, janë bërë gati për tu futur në prodhim.

PRODHIMI I PELLETIT

Pelleti është një prej biomasave më të përdorura për prodhimin e nxehtësisë.

Prodhimi i tij arrihet përmes përpunimeve të thjeshta mekanike të lendeve të para drusore, etj, duke ua nënshtruar tallashin dhe ashklat e copetuara të tyre, presioneve shumë të larta. Materiali detyrohet pastaj të kalojë njëkohësisht përmes një mulliri me vrima të dimensioneve të ndryshme, ndërsa nxehtësia e çliruar gjatë këtyre fazave të përpunimit, aktivizon efektin lidhës të një substance natyrale e pranishme tek druret dhe materialet e tjera, që do të determinojë me pas kompaktesinë dhe formën karakteristike cilindrike të pelletit me kohen.

Pelleti është një produkt teresisht natyral dhe miqësor ndaj mjedisit.

Pelleti paraqet alternativën më të vlefshme të lendeve djegëse tradicionale për ngrohje. Është lehtësisht i gjetshëm, praktik për t'u transportuar, ekologjik, ekonomik dhe i sigurt.

Pelleti prodhohet nga kompresimi i tallashit, dhe ashklave të drurit.

Nëse materiali është i lagësht, ai duhet të jetë tharë përpara pelletizimit. Përbajtja

optimale e lagështisë është 10 - 15%. Përbajtja e lagështisë jep proporcionin e ujit

të avullueshëm në peshën totale të materialit. Druri i butë është një lëndë e parë për pelletin e drurit pak më mirë se druri i fortë për shkak të përbajtjes më të lartë të "liniit-es". Kjo e fundit është një material lidhës natyral i fibrave të drurit dhe gjithashtu material lidhës i pelletit.

Fazat e prodhimit te pelletit jane:

- **Tharje e mundshme te lendes se pare**
- **Bluarje**
- **Pelletizimin**
- **Ftohje**
- **Shoshitje**
- **Paketim/magazinim**

Procesi i tharjes kryhet ne nje thares. Tharja nuk eshte e nevojshme, nese lenda e pare perbehet nga ashkla apo tallash i thate. Sidoqofte, nese eshte perdorur tallash i laqesht ai duhet te thahet perpara bluarjes. Zakonisht per bluarje perdoret nje cekic bluares, kur per prodhimin e pelletit eshte perdorur lende e pare homogjene. Ne bluarje, lenda e pare bluhet ne madhesine e nje kokrre te barabarte te pakten me diametrin e pelletit (6 - 12 mm). Sidoqofte, pluhuri i bluar nuk duhet te jete shurne i imet, per aq sa nuk ka me fibra qe pjeserisht lidhin pelletin. Bluarja dhe tharja e lendes se pare mund te kombinohen, nese kerkohet tharja. Ne nje bluares-thares, bluaresi ndryshon madhesine e grimcave te tallashit, qe eshte thare. Bluarja e ben procesin e tharjes shume me te lehte.


Pelleti kompresohet ne shtypesa te sheshte ose shtypesa unazore te montuara vertikalisht. Normalisht ne kompresimin e pelletit te drurit nuk perdoren additive, por pelleti lidhet nga kohezioni i siperfaqeve te brendeshrne, nga pjeset fibroze te grimcave, dhe kryesisht nga adezioni i shkaktuar nga "linjin-a" qe eshte zbutur nga nxehtesia e larte qe clirohet gjate kompresimit. Temperatura e materialit te drurit te bluar rritet ne kompresorin e pelletit dhe materiali lidhes natyral, "linjin-a", shkrin dhe lidh pelletin gjate ftohjes. Prandaj, pelleti nuk e fiton forcen deri sa te ftohet. Shtypesi gjithmone zgjidhet rast pas rasti, zgjedhje qe varet nga karakteristikat e kualitetit (fortesia, laqeshtia, perberja) te lendes se pare qe do te kompresohet.

Ftohja eshte nje faze shume e rendesishrne e procesit. Pas kompresimit temperature e pelletit eshte e larte, zakonisht rreth 90°C. Laqeshtia e çliruar ne fazen e kompresimit eshte larguar me nxehtesi nga produkti. Ftohja stabilizon pelletin dhe forcon "liniin-en" e shkrire ne siperfaqen e tij, dhe prandaj forma e pelletit mbetet e pandryshuar.

Ne shoshitje, pluhuri i lendes se pare i perzier me pelletin veçohet dhe rikthehet mbrapsht serish ne procesin e pelletizimit. Shoshitja zakonisht kryhet me nje shoshe vibruese per te siguruar nje produkt homogjen qe nuk shkakton problem ne konvejeret dhe pajisjet djegese.

Tallashi i presuar (pellet i paster) nxirret nga depozita me ane te valvolave peshohet dhe paketohet nga makina e peshim-ambalazhimit. Ne perfundirn, pelleti **transportohet ne dhomen**

e magazinimit ose paketoht ne thase te vegjel ose te rnedhenj per t'u transportuar direkt ne konsumatoret. Mund te magazinohet ne sasira te rnedha ne ambiente te posaqme ose ne silos, te brendshem dhe te jashtern, te madhesive te ndryshme ne varesi te nevojave.





3. MENAXHIMI I MBETJEVE

Mbetjet jo te rrezikshme si lende e pare

Mbetjet jo te rrezikshme qe do te meren per mundesi perpunimi do te sigurohen nga subjekte te ndryshme me te cilat kompania do te lidhe kontrate furnizimi.

Keto mbetje do te jene paleta te perdorura nga subjekte te tjera te cilat i kane nxjere jashte perdorimit ne aktivitetet e tyre respektive. Gjendja e ketyre paletave eshte shume e mire. Ato do te magazinohen ne oborrin e magazines, do te seleksionohen sipas kategorise, dhe do te futen ne prodhim, per paleta te reja dhe pelet.

Transporti i ketyre mbetjeve do te kryhet me subjekte te licensuara per transport mbetjesh jo te rrezikshme, me te cilat kompania do te lidhe kontrat bashkepunimi.

Kompania synon qe te pajiset dhe vete me License III2B, ne menyre qe te siguroje transportin per keto lende me ane te stafit te saj.

Prodhimi i Paletave

Marria ne dorrezim e materialit:

Lenda e pare sillet nga Bosnja ne formen e “Lende druri e pasharuar bredhi”. Me poshte jepet nje foto e fatures se zhdoganimit per kete lende te pare.

Magazinimi

Lënda e parë stivoset brenda ambienteve të magazines dhe me pas futet në proces për perpunimin e paletave.

Prodhimi i peletave

Lenda e pare

Materiali i dale nga perpunimi i drurit per prodhim paleti, (ashkla druri, tallash, etj).

Magazinimi

Lenda e pare transferohet prane impiantit te prodhimit te peletit me anen e thasave dhe magazinohet ne siperfaqet e destinuara per kete qellim deri ne momentin e futjes ne proces, te temperature dhe lageshti te kontrolluar.

Aktiviteti i prodhimit te paletave do te gjeneroje terpica druri te cilat do te dalin ne formen e ashklave ose tallashit. I gjithë ky material do te futet ne perpunim per krijimin e peletes. Ne kete menyre nuk do te gjenerohet asnje sasi mbetje druri qe nuk mund te shfrytezohet pasi cdo sasi druri e sjelle ne magazine do te perdoret per prodhimin e paletave apo peletit.

Mbetje te cilat do te gjenerohen nga aktiviteti per prodhim peleti nuk do te kete.

Lloji i vetem i mbetjes se gjeneruar do jete ai i mbetjes urbane qe do te dale nga aktiviteti njerzor i punonjesve.

Emri: Mbetje urbane

- Përshkrimi dhe natyra e mbetjes; Mbetje ushqimore/plastikë/ letër.
- Burimi; Nga punonjësit
- Ku magazinohet dhe karakteristikat e hapësirës së magazinimit; Kosha mbetjesh të posatshem

- Sasia/volumi në ton dhe m³; 0.8 ton/muaj
- Periudha(t) e gjenerimit; Ditore
- Analizat (duke përfshirë testimin dhe metodat e sigurimit të cilësisë); N/A
- Kodi sipas listave të mbetjeve referuar legjislacionit Shqiptar mbi Kategoritë e Mbetjeve;

20 01 02 / 20 01 39 / 20 01 01

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Lidhur me natyrën e veprimtarisë dhe organizimin e hapësirave të punës dhe rregullimin e fasiliteve, burimet prej të cilave gjenerohet ndotje vlerësohet të jenë:

- Automjetet e transportit prej të cilave krijohet përhapja e pluhurave. Ky fenomen ndikohet mjaft edhe nga kushtet atmosferike.
- Zhurmat gjenerohen nga makinerite gjate procesit te punes.

4.1 SHKARKIME NE MJEDIS

Aktiviteti nuk do te kete shkarkime me natyre flururese ne ajer sikurse dhe nuk ka pika shkarkimi ne ujerat siperfaqesore. Procesi i prodhimit te peletit dhe paletave nuk perfshin perdorimin e ujit ne asnje faze te tij. Shoqëria nuk shkarkon në rrjetin e kanalizimeve. Ujërat e ndotura shkarkohen ne kanalin mbledhes te ujerave te zeza zones, i cili menaxhohet nga pushteti lokal. Prodhimi i paletave dhe peletit nuk parashikon perdorimiin e ujit ne asnje proces, si rrjedhoje asnje shkarkim uji nga prodhimi nuk gjenerohet. Shoqëria nuk do të shpërndajë mbetje në tokë. Mbetjet kryesore që gjenerohen nga aktiviteti, janë mbetje urbane te cilat menaxhohen duke u shkarkuar ne vendgrumbullimet e mbetjeve te percaktuara nga bashkia te cilat gjithashtu menaxhohen me tej nga pushteti lokal.

Zhurmat

Aktiviteti i punes është i tille qe nuk ka burime fikse te zhurmes, duke qene se procesi i punes perfshin vetem perpunimin e drurit. Gjithashtu impianti i instaluar eshte i nje teknologjie te larte qe minimizon maksimalisht gjenerimin e ndotjes akustike gjate funksionimit. Gjithsesi si impakt zhurma mund te vije nga mjetet e transportit te mbetjeve. Subjekti kujdeset qe transporti te kryhet ne orare te caktuara (jo heret ne mengjes apo vone ne mbremje), si dhe makinerite e kompanise transportuese te jene ne gjendje te mire pune dhe i nje viti te ri prodhimi.

Megjithate vlen te theksohet se ne afersi te zones nuk ndodhen zona te banuara per te ndikuar negativisht.

Vlerësimi i zhurmeve që do të shkaktohen nga aktiviteti do të bazohet ne legjislacion Shqiptar, konkretisht sipas Udhezimit Nr.8 datë 27/11/2007 “ Për nivelet kufi të zhurmeve në mjedise të caktuara”.

Flora dhe fauna

Nuk parashikohen ndikime ne bimësi duke përmendur lloje endemike, lloje me status të veçantë, habitate me vlere, ekosisteme funksionale etj.

Gjenerimi i mbetjeve

Aktiviteti i prodhimit te paletave dhe peletit nuk gjeneron mbetje. Mbetjet e vetme qe do gjenerohen jane ato me natyre urbane nga punonjesit, te cilat do depozitohen ne vendgrumbullimet e percaktuara nga pushteti lokal.

Peisazhi

Peisazhi nuk do pesoje ndryshime vizuale. Madje edhe projekti arkitektonik ka parashikuar zone te gjelber te mbjelle rreth gofines.

Ndikime në cilësinë e jetës

Çdo veprimtari që zhvillohet nga njeriu në mjedis shkakton ndikime të cilat i pëson vetë njeriu dhe mjedisi. Ndikimet të cilat mund të shkaktohen gjatë zbatimit të projektit dhe që mund të ndikojnë në jetën e banorëve janë të gjitha ndikimet e lartpërmendura:

- Emetimet në ajër
- Ndotja e ujërave sipërfaqësore
- Zhurmat
- Toka
- Biodiversiteti
- Peizazhi

Këto ndikime do të jenë në ato nivele që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte. Megjithatë nivelet e këtyre ndikimeve janë të ulta dhe këto ndikime janë krejtësisht të kthyeshme pas mbylljes së projektit nëpërmjet rehabilitimit të zonës.

Zhvillimi i çdo aktiviteti në një zonë të caktuar ka edhe ndikim pozitiv në jetën social-ekonomike të zonës. Banorëve të zonës u jepet mundësia e punësimit dhe zhvillimi i bizneseve të vogla të cilat mund të ofrojnë shërbime të ndryshme për punëtorët të cilët do të punësohen në këtë projekt. Çdo aktivitet nëpërmjet sistemit tatimor shton edhe të ardhurat në pushtetin lokal çka sjell edhe mundësinë e investimeve të ndryshme në zonën e projektit nga bashkia përkatëse.

Masat per minimizimin e ndikimeve

Toke

- Kontroll teknik te makinerive per eliminimin e avarive te ndryshme qe mund te lindin
- Mbajtja e nje regjistri te caktuar per mbetjet dhe per incidentet me karburantet
- Trajnim periodik te punonjesve
- Mbetjet urbane jane ne sasi te vogel. Mbetjet meren cdo dite nga punonjesit ose nga nje person pergjegjes per tu derguar ne kontenieret e percaktuar nga pushteti vendor

Ajer

- Lagje e sheshit kryesor me uje per minimizim te pluhurave dhe gazeve
- Ulje e shpejtesise se makinerive per minimizimin e pluhurave
- Monitorim periodik i pluhurave dhe gazeve
- Kontroll periodik i makinerive per te siguruar emetim brenda normave te lejuara

Zhurma e Vibrime

- Ulje e shpejtesise se makinerive per ndotjen akustike
- Monitorim periodik
- Mirembahen automjetet e punes
- Ndalohet renia e borive ne zonat e banuara
- Ne zonat e banuara qarkullohet me shpejtesi te kufizuar
- Makinat e transportit dhe pajisjet jane bashkekohore dhe plotesojne standartet kombetare, te pajisura me marmite selenciatore te pakesimit te zhurmave

Peisazhi

Për zbutjen e ndikimeve nga prania e projektit në peizazhin natyror subjekti të zbatojë këto masa:

- Përreth sheshit të mbillen pemë të larta;
- Mjedis të mbahet i sistemuar dhe i pastër;

-
- Të shmangen shkaktimi dhe përhapja e pluhurit në atmosferë;

Të shmangët grumbullimi i mbetjeve për një kohë të gjatë.

Ndikime në cilësinë e jetës

- Subjekti të zbatojë të gjitha masat e paraqitura për të gjithë parametrat mjedisorë me qëllim që ndikimet negative nga veprimtaria të jenë të moderuara;
- Subjekti si gjatë fazës operimit të punësojë sa më shumë persona nga zonat përreth;

Subjekti do të marr në konsideratë çdo shqetësim të banorëve që mund të kenë nga zhvillimi i veprimtarisë.